

ASSE, më shumë se një mundësi ...

Në këtë numër:

ASSE, më shumë se një mundësi ...	1
Si të anëtarësohemi në ASSE?	2
Mbledhja e Asamblesë së ASSE-s	3
ASSE Newsletter	3
Konferenca e parë e ASSE-s	4
Call for papers	4

E themeluar më nëntor 2009 në Departamentin e Gjuhëve të Huaja në Universitetin e Vlorës dhe me mbështetjen e departamenteve simotra të universiteteve shqiptare, ku do të veçonim atë të Durrësit dhe Tiranës, kjo organizatë jofitimprurëse, tashmë një vjeçe e pak muajshe, ecën e sigurt në rrugën e saj të suksesit. Në saj të një plani afatgjatë aktivitësh dhe programesh ambicioze, të cilat do të realizohen së shpejti, ASSE kërkon të shndërrohet në një pikë referimi për të gjithë studiuesit shqiptarë në fushën e studimeve britanike dhe amerikane.

Një nga sukseset dhe arritjet më të mëdha të ASSE-s, për vitin që lamë pas, ishte padyshim **anëtarësimi i saj në ESSE**. Në saj të këtij anëtarësimi, ASSE është sot përfaqësuesi zyrtar i studimit dhe i kërkimit në gjuhën, kulturën dhe letërsinë angleze në kuadrin evropian. Ky anëtarësim i mundëson studiuesit dhe mësimdhënësit shqiptar të anëtarësuar në ASSE këto lehtësira:

1. të marrë pjesë në konferenca shkencore të organizuara nga ESSE në çdo vend të botës me tarifa të reduktuara
2. të përfitojnë nga skema e financimit që ofron ESSE
3. të vendosi kontakte me kërkues të huaj

Një tjetër arritje e rëndësishme e ASSE-s është edhe buletini shkencor i shoqatës i titulluar *in esse: English Studies in Albania*. Ky buletin shkencor botohet dy herë në vit. Numri i parë i tij do të dalë në pranverë 2011, ndërsa në muajt në vazhdim do të hapet thirrja për artikuj për numrin e dytë të buletinit shkencor.

Një aktivitet tjetër ambicioz, i cili synon t'i bëj jehonë veprimtarisë së ASSE-s, por jo vetëm, është edhe organizimi i konferencës së parë ndërkombëtare mbi studimet amerikane dhe britanike. Kjo konferencë, ashtu edhe si na sygjeron edhe vetë titulli "Only connect . . .", ka si prioritet pjesëmarrjen e sa më shumë studiuesve shqiptar dhe të huaj.

Pra, si përfundim ASSE ju ofron një mundësi më shumë, një dritare akademike e cila ju lehtëson lidhjen me kërkuesit e studimeve britanike dhe amerikane në Evropë e më gjerë.



ASSE Newsletter

Nr.3

Janar 2011

Si të anëtarësohemi në ASSE?

Në bazë të statutit të ASSE-s, neni 4 dhe 5 për procedurat e anëtarësimit ju vë në dukje se ka dy kategori anëtarësh:

Janë anëtarët e thjeshtë ku bëjnë pjesë të gjithë ata studiues, kërkues dhe mësimdhënës të cilët operojnë në nivel universitar. Ata kryejnë të gjitha detyrimet dhe gëzojnë të drejta të plota.

Janë anëtarët e nderit që propozohen nga Këshilli Drejtues i ASSE-s në bazë të kriterëve të përcaktuara paraprakisht dhe miratohen në Mbledhjen e Përgjithshme. Anëtarët e nderit janë personalitete me kontribut të veçantë në studimin e anglishtes në Shqipëri. Ata nuk paguajnë kuotën vjetore të regjistrimit dhe gëzojnë të njëjta të drejta me anëtarët e thjeshtë.

Procedura që duhet të ndiqni për t'u bërë anëtarë të ASSE-s është e thjeshtë. I gjithë informacioni i nevojshëm gjendet në faqen zyrtare të organizatës (www.assenglish.org/membership/). Pasi të keni shkarkuar dhe plotësuar formularin e aplikimit, ju duket ta nisni atë në adresën armelap@assenglish.org. Këshilli Drejtues ka të drejtë të vendosi për pranimin ose jo të aplikimit në fjalë. Nëse aplikimi pranohet atëherë individi i pranuar duhet të derdhi kuotën vjetore pranë bankës së Tiranës (Tirana Bank) në numrin e llogarisë së mëposhtme:

Bank: Tirana Bank
 Bank account number: 0710-258973-002
 IBAN: AL39 2062 6022 0000 7102 5897 3002
 SWIFT CODE: TIRBALTR
 Purpose of payment: ASSE Membership Fee
 Account Holder: Bledar Toska



ASSE Newsletter

Nr.3

Janar 2011

Mbledhja e Asamblesë së ASSE-s

Më datë 9 nëntor 2010, në Universitetin e Vlorës u mbajt Asambleja e parë e shoqatës. Në këtë asamble u diskutuan çështje me shumë interes si:

1. u përcaktua plani i aktiviteteve të shoqatës për dy vitet e ardhshme
2. u zgjodhën anëtarët e Ekzekutivit të shoqatës, ku u vendos si më poshtë:

Kryetare e shoqatës - Armela Panajoti, e cila është zyrtarisht përfaqësuesja e shoqatës në marrëdhënie me të tretë. Kryetari thërret mbledhjet e këshillit drejtues, kryeson punimet e Asamblesë së Përgjithshme, i propozon këshillit drejtues planin e aktiviteteve të shoqatës, autorizon veprimet financiare, firmos vendimet e Këshillit Drejtues dhe korrespondencën e shoqatës.

Sekretar i shoqatës - Bledar Toska, i cili është përgjegjës për dokumentacionin e shoqatës.

Drejtor i thesarit - Artur Jaupaj, i cili kryen të gjitha veprimet financiare të shoqatës dhe përgatit raportin financiar për Asamblenë e Përgjithshme.

Anëtarët - Elida Tabaku, Marsela Turku, të cilat janë përgjegjëse për organizimin e aktiviteteve të tjera të shoqatës, si organizimi i konferencës së përvitshme shkencore, botimin e buletin shkencor dhe përgatitjen e Newsletter-it.

- 3- u diskutua mbi anëtarësimet e reja
- 4- u diskutua mbi kuotacionet që duhet të derdhen anëtarët
- 5- u përcaktua titulli i konferencës, tematika etj.

ASSE Newsletter

ASSE boton çdo tre muaj *newsletter*-in e vet. Ky *newsletter* do të shërbejë si zëri i i ASSE-s për të përcjellë mesazhe të ndryshme, për të botuar njoftime në lidhje me thirrje për konferenca apo buletine brenda dhe jashtë Shqipërisë. ASSE fton të gjithë ata që dëshirojnë të botojnë mendimet e tyre në lidhje me çështje që prekin probleme të karakterit shkencor apo edhe teknik në lëmin e studimeve në gjuhën angleze. Gjithashtu nëse keni thirrje të ndryshme për të botuar me qëllimin për t'i bërë të ato njohura, ASSE ju mirëpret të kontaktoni në adresën elektronike mturku@assenglish.org.



ASSE Newsletter

Nr.3

Janar 2011

Konferenca e parë e ASSE-s

ASSE organizon konferencën e saj të parë në datat 11-13 qershor 2011 në Universitetin e Vlorës. Qëllimi i këtij takimi shkencor është padyshim bashkimi i të gjitha forcave kërkuese në fushën e studimeve në gjuhën angleze që veprojnë në Shqipëri.

Në mënyrë simbolike konferenca është titulluar “Only connect ...” duke u frymëzuar nga epigrafi i romanit të shkrimtarit anglez E. M. Foster *Howards End*, për të shërbyer si një slogan bashkues dhe një mesazh kuptimplotë për këtë aktivitet të parë. Në planin shkencor ajo synon të eksplorojë idenë e lidhjes në aspektin gjuhësor, kulturor dhe letrar dhe sidomos në kontekstin e shekullit të njëzet e një.

Në këtë aktivitet janë të ftuar si folës kryesorë, **Prof. Fernando Galván**, i cili është edhe kryetari i ESSE-s, **Dr. Slávka Tomáščiková**, e cila është sekretare e ESSE-s si dhe **Prof. Josef Schmied nga** Chemnitz University of Technology ne Gjermani.

Jemi shumë entuziastë për praninë e ekzekutivit të ESSE-s në këtë konferencë, jo vetëm për faktin se na nderojnë me pjesëmarrjen e tyre në këtë aktivitet si folës kryesore, por edhe me një qëllim tjetër. Ekzekutivi i ESSE-s planifikon mbajtjen e mbledhjes së tij të radhës në Vlorë, para hapjes së konferencës. Prania e tyre konsiderohen e rëndësishme jo vetëm për promovimin e shoqatës, por edhe për njohjen e studiuesve shqiptarë me ESSE-n dhe fokusin e veprimtarisë së saj.

Call for Papers

First ASSE International Conference on British and American Studies

“Only connect ...”

hosted by the Department of Foreign Languages, Faculty of Humanities, University of Vlora

11-13 June 2011

Deadline for proposals: 31 March 2011

“Only connect! That was the whole of her sermon. Only connect the prose and the passion, and both will be exalted, and human love will be seen at its height. Live in fragments no longer. Only connect, and the beast and the monk, robbed of the isolation that is life to either, will die.”

Howards End, E. M. Forster

“Only connect ...” the epigraph to Forster’s novel *Howards End* was to become his motto not only in this book but also in his fiction. Although contrasts are central to his fiction,

Forster goes in search of a point of connection between different worlds, classes, cultures, values and ideas. The conference uses Forster's epigraph as a point of departure for interesting papers that seek to explore the notion of connection in literature, culture and language.

Being the first ASSE International Conference "Only connect..." is also conceived as a slogan, which aims to bring together scholars in English and American Studies from Albania and abroad.

Papers are welcomed from but are not limited to:

- British and Commonwealth Literature
- American Literature
- Literary Theory
- Literary Criticism
- Cultural Studies
- Discourse Analysis
- Pragmatics
- Linguistics
- Semiotics
- Translation Studies

The conference language is English. Please send your abstracts (about 250 words) for papers (20 min) as an MS word attachment to the following Email-address by 31 March 2011:

onlyconnect@assenglish.org

Abstracts should include:

1. title of paper
2. name and affiliation
3. e-mail address
4. section
5. 3-5 keywords

All papers will be considered for publication in the journal [in esse: English Studies in Albania](#).



ASSE Newsletter

Nr.3

Janar 2011

Trends

in esse: English Studies in Albania

Deadline for submitting articles: 30 April 2011

ASSE (Albanian Society for the Study of English) and the Department of Foreign Languages, University of Vlora would like to announce this call for papers for contributions for its secons issue of *in esse*: **English Studies in Albania**, which is a scholarly journal devoted to the promotion of original work in linguistics, literary and translation studies and language teaching by scholars working in Albania and abroad. The present issue is entitled *Trends* and aims at bringing together recent and intriguing perspectives and tendencies on matters of English or English studies.

Deadline for submissions: 30 April 2011

Articles should not exceed 6000 words. Please send articles as an e-mail attachment to Doc. Armela Panajoti (armelap@assenglish.org) or Marsela Turku (mturku@assenglish.org). Please include a 250-word abstract and 4-5 keywords. Please follow the Chicago Manual of Style for citation.

Call for Papers

in esse: English Studies in Albania

ASSE planifikon dy numra për buletinin *in esse* për vitin 2011. Të gjithë anëtarët janë të lutur dhe të mirëpritur të bëjnë propozimet e tyre për titujt e mundshëm për këto numra të radhës. Të gjitha propozimet është mirë tu dërgohen me e-mail të gjithë anëtarëve të shoqatës, në mënyrë që të krijohet një rreth diskutimi dhe në fund të vendosim për titujt e dy numrave për vitin 2011.